

Buletini mujor

11/07/2023

Oda Ekonomike e Kosovës,
Nëna Terezë, 10000 Prishtinë
www.oek-kcc.org, info@oek-kcc.org,
038 224 299

PËRMBAJTJA

1. Pasqyrë e Ekonomisë


Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) është organizatë profesionale e themeluar në vitin 1962 nga Kuvendi i Kosovës. Është institucion në shërbim të ekonomisë kosovare, partner konstruktiv i institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës, partner në dialogun social si dhe promotor i zhvillimit ekonomik dhe politikave të mira makroekonomike.

OEK-u është organizatë profesionale, e pavarur, jopolitike dhe jo-fitimprurëse. Është përfaqësuese legjitime e interesave të komunitetit të biznesit në Kosovë. Është burim i besueshëm i informatave për ndërmarrjet kosovare si dhe për ndërlidhjen me partner ndërkombëtar, analizon gjendjen ekonomike të Kosovës dhe aktivisht propozon forma të reja dhe të avancuara të biznesit vendor dhe bën ndërkombëtarizimin e ndërmarrësisë kosovare. Ka shtrirje në të gjitha rajonet kryesore të Kosovës.

1. Pasqyrë e Ekonomisë së Kosovës

Bruto Produktit Vendor për tremujorin e parë të vitit 2023, sipas aktiviteteve ekonomike dhe me qasjen e shpenzimeve, me çmime aktuale dhe me çmime të vitit paraprak. BPV-ja në tremujorin e parë të vitit 2023 shënon rritje reale për 3.91% krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Rritja reale e BPV-së sipas aktiviteteve ekonomike është si vijon: Aktivitetet ekonomike që kishin rritje në këtë tremujor janë: Informacioni dhe komunikimi 14.98%, Aktivitete shkencore, profesionale dhe teknike; aktivitete të shërbimeve administrative dhe mbështetëse 10.31%, Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave; transporti dhe magazinimi; aktivitete të akomodimit dhe shërbimit ushqimor 9.69%, Arte, argëtim dhe çlodhje, aktivitete të prodhimit të mallrave të familjeve për përdorim të vet dhe shërbime të tjera 7.49%; Aktivitetet financiare dhe të sigurimit 7.38%; Industria nxjerrëse; përpunuese; energjia elektrike, gaz, avulli dhe furnizimi me ajër; furnizimi me ujë; aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, rehabilitimit 5.93%; Bujqësia, pyjet

Fig. 1: Rritja reale e BPV-së tremujore krahasuar me periudhën përkatëse të vitit paraprak



dhe peshkimi 3.59%; Aktivitete të pasurive të paluajtshme 2.13%; Ndërtimtaria 1.37%. Aktivitetet ekonomike që shënuan rënie në këtë tremujor janë: Administrata publike, sigurimi social, arsimit dhe shëndetësia (0.77%).

Komponentët e BPV-së sipas metodës së shpenzimeve që kishin rritje janë: Eksporti i shërbimeve 24.43%, Importi i shërbimeve 22.95%, Formimi i bruto kapitalit 1.02%, Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake dhe IJPSHESH 0.87%.

Ndërsa rënie kishte: Eksporti i mallrave (2.16%), Importi i mallrave (1.02%), Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë (1.40%).¹

¹ Bruto Produkti Vendor (BPV) me Qasjen e Shpenzimeve dhe të Prodhimit, TM1 2023 |

Statistikat tregtare për muajin Maj 2023

Bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), tregojnë për një deficit tregtar më të larët për (20.5%) në muajin maj 2023, në raport me periudhën e njëjtët të vitit 2022, gjegjësisht në vlerë prej 443,3 milion euro krahasuar me deficitin 367,8 milion euro në vitin 2022. Eksporti mbulon importin (14.4%).

Eksporti i mallrave në muajin maj 2023 kishte vlerën 74,7 milion euro, ndërsa importi 518,1 milion euro, është një rënje prej (1.6%) për eksport si dhe një rritje (16.7%) për import duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022..

Sipas të dhënave të grupeve kryesor të eksportit e përbëjnë: (24.3%) metalet bazë dhe artikujt prej tyre, (16.5%) artikuj të ndryshëm të prodhuar, (13.2%) plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre, (10.5%) ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, (7.0%) produktet minerale, (5.1%) tekstil dhe artikuj tekstili, etj.²

Ndërsa sipas të dhënave të grupeve kryesor për import e përbëjnë: (13.6) produktet minerale, (12.1%) ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani, (11.7%) makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike, (10.8%) mjetet e transportit, (10.2%) metalet bazë dhe artikujt prej tyre, (6.9%) produkte të industrisë kimike, (6.3%) plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre, etj.³

Tab.1: Qarkullimi i mallrave në tregtinë e jashtme

(në mijë Euro)

Periudha	Eksportet (FOB)	Importet (CIF)	Bilanci tregtar	Përqindja e mbulimit
1	2	3	4=2-3	5=2/3
2022	920.405	5.639.393	-4.718.989	16,3
01-2022	64.220	338.114	-273.894	19,0
02-2022	65.256	414.770	-349.515	15,7
03-2022	88.600	493.917	-405.317	17,9
04-2022	80.997	462.742	-381.745	17,5
05-2022	76.033	443.892	-367.859	17,1
06-2022	74.642	492.832	-418.190	15,1
07-2022	76.298	502.414	-426.116	15,2
08-2022	84.891	526.829	-441.938	16,1
09-2022	77.059	478.167	-401.109	16,1
10-2022	86.402	488.774	-402.372	17,7
11-2022	73.955	475.419	-401.464	15,6
12-2022	72.054	521.522	-449.469	13,8
01-2023	62.175	353.720	-291.545	17,6
02-2023	73.170	390.688	-317.518	18,7
03-2023	81.776	508.580	-426.804	16,1
04-2023	67.299	448.259	-380.960	15,0
05-2023	74.779	518.125	-443.347	14,4

² Agjencia e Statistikave të Kosovës -Statistikat e Tregtisë së Jashtme(Eksporti), Maj 2022- 2023

³ Agjencia e Statistikave të Kosovës -Statistikat e Tregtisë së Jashtme (Importi), Maj 2022- 2023

Tregtia e jashtme e mallrave me 27 vendet e BE-së

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 21,8 milion euro, ose rreth (29.2%) e eksporteve të përgjithshme, me një rënje prej (3.0%). Partneret kryesor për eksportin e mallrave në BE janë: Gjermania (9.7%), Italia (4.0%), Holanda (3.1%), etj.⁴

Tab.2: Eksportet në muajin maj 2022- 2023 me vendet e BE-së

Vendet	Maj - 2022		Maj - 2023	
	Vlera	%	Vlera	%
	Eksportet (FOB)			
Gjithsej	76.033	100,0	74.779	100,0
27 vendet e BE_së	22.524	29,6	21.851	29,2
Austria	620	0,8	1.628	2,2
Belgjika	1.004	1,3	1.477	2,0
Danimarka	1.175	1,5	119	0,2
Franca	1.212	1,6	1.236	1,7
Gjermania	7.657	10,1	7.283	9,7
Greqia	492	0,6	511	0,7
Holanda	1.756	2,3	2.288	3,1
Hungaria	165	0,2	440	0,6
Irlanda	3	0,0	1	0,0
Italia	4.668	6,1	2.964	4,0
Luksemburg	42	0,1	37	0,0
Polonia	111	0,1	343	0,5
Republika Çeke	69	0,1	102	0,1
Slovakia	264	0,3	9	0,0
Slovenia	188	0,2	441	0,6
Spanja	63	0,1	385	0,5
Suedia	395	0,5	483	0,6
Rumani	260	0,3	441	0,6
Bullgaria	1.302	1,7	717	1,0
Kroacia	1.004	1,3	819	1,1
Të tjera të BE_së	73	0,1	127	0,2

⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës Tregtia e Jashtme e Mallrave (Eksporti sipas vendeve të BE-së), Maj 2022-2023

Importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 215,2 milion euro, ose (41.5%) e importeve të përgjithshme, me një rritje prej (14.1%). Importet me pjesmarje me të lartë ishin nga: Gjermania (13.0%), Greqia (5.6%), Italia (5.6%), etj.⁵

Tab.3: Importet në muajin maj 2022- 2023 me vendet e BE-së

Vendet	Maj - 2022		Maj - 2023	
	Vlera	%	Vlera	%
	Importet (CIF)			
Gjithsej	443.892	100,0	518.125	100,0
27 vendet e BE_së	188.614	42,5	215.254	41,5
Austria	7.621	1,7	8.098	1,6
Belgjika	1.768	0,4	2.554	0,5
Danimarka	964	0,2	1.823	0,4
Franca	5.891	1,3	6.251	1,2
Gjermania	51.205	11,5	67.441	13,0
Greqia	28.573	6,4	28.783	5,6
Holanda	3.461	0,8	3.380	0,7
Hungaria	7.031	1,6	6.279	1,2
Irlanda	818	0,2	1.002	0,2
Italia	22.519	5,1	29.216	5,6
Luksemburg	216	0,0	223	0,0
Polonia	10.958	2,5	13.950	2,7
Republika Çeke	4.035	0,9	5.676	1,1
Slovakia	1.152	0,3	1.610	0,3
Slovenia	12.825	2,9	8.131	1,6
Spanja	3.809	0,9	5.266	1,0
Suedia	952	0,2	1.381	0,3
Rumani	6.333	1,4	6.818	1,3
Bullgaria	9.091	2,0	7.207	1,4
Kroacia	7.493	1,7	8.166	1,6
Të tjera të BE_së	1.896	0,4	2.000	0,4

⁵ Agjencia e Statistikave të Kosovës Tregtia e Jashtme e Mallrave (Importi sipas vendeve të BE-së), Maj 2022-2023

Tregtia me vendet e CEFTA-së

Në muajin maj 2023, eksportet e Kosovës me vendet CEFTA-së arritën në 33,1 milion euro, ose (44.3%) të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej (6.9%). Partner kryesor për eksport nga vendet e CEFTA-së janë: Shqipëria (15.3%), Maqedonia (14.8%), Serbia (6.9%), Mali i zi (5.9%).

Tab.4: Eksportet në muajin maj 2022- 2023 me vendet e CEFTA-s

Vendet	Maj - 2022		Maj - 2023	
	Vlera	%	Vlera	%
Eksportet (FOB)				
Gjithsej	76.033	100,0	74.779	100,0
CeFTA	31.008	40,8	33.145	44,3
Shqipëria	10.244	13,5	11.406	15,3
Maqedonia	11.390	15,0	11.058	14,8
Mali i Zi	2.864	3,8	4.434	5,9
Serbia	5.584	7,3	5.161	6,9
Bosnja dhe Hercegovina	926	1,2	1.060	1,4
Moldavia	0	0,0	26	0,0

Ndërsa, importet nga vendet e CEFTA-së në muajin maj 2023, arritën në 96,8 milion euro, ose (18.7%) të importeve të përgjithshme, me një rritje prej (16.9%). Vendet me pjesmarje më të lartë për import ishin: Shqipëria (6.8%), Serbia (5.3%), Maqedonia (5.2%).

Tab.5: Importet në muajin maj 2022- 2023 me vendet e CEFTA-s

Vendet	Maj - 2022		Maj - 2023	
	Vlera	%	Vlera	%
Importet (CIF)				
Gjithsej	443.892	100,0	518.125	100,0
CeFTA	82.832	18,7	96.824	18,7
Shqipëria	21.018	4,7	35.024	6,8
Maqedonia	22.726	5,1	26.840	5,2
Mali i Zi	1.975	0,4	1.811	0,3
Serbia	31.813	7,2	27.428	5,3
Bosnja dhe Hercegovina	5.287	1,2	5.713	1,1
Moldavia	14	0,0	7	0,0

Tregtia me vendet e tjera të botës

Eksportet e Kosovës me vendet tjera arritën në 19,7 milion euro, ose (26.5%). Si partner më të rëndësishëm nga këto vendet për eksport vlen të përmendën: SHBA (11.7%), dhe Zvicra (7.7%).




Fig.2: Eksportet e Kosovës me vendet e tjera për muajin maj 2023

Ndërsa importet e Kosovës me vendet tjera arritën në 206,0 milion euro, ose (39.8%). Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Turqia (14.6%) dhe Kina (10.3%).⁶





Fig.3: Importet e Kosovës me vendet e tjera për muajin maj 2023

⁶ Agjencia e Statistikave të Kosovës –Tregtia e Jashtme e Mallrave (Eksporti dhe Importi me vendet e tjera të botës maj 2023

Inflacioni mujor dhe vjetor


Inflacioni mujor i matur nga indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit ishte 0.1 nga pemët dhe perimet (0.1 %), me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0.6%.

Fig.4: Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK), Qershor 2022- Maj 2023 ndryshimet mujore të çmimeve në përqindje



dhe qumështi, djathi dhe vezët (- 0.1%) me një ndikim prej -0,5 për qind në IHÇK-it. Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i ulët në një mesatare prej 5.5 % për qind në muajin maj 2023 krahasuar me muajin maj 2022.

Fig.5 Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK), Qershor2022- Maj 2023 ndryshimet vjetore të çmimeve në përqindje



Ndërsa rënie e çmimeve vërehet të grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (-0.3%)

Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë të grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: buka dhe drithërat (0.9 %), mishi (0.8%), qumështi, djathi dhe vezët (0.8%), perimet (0.5%), energjia elektrike (0.5%), pijet joalkoolike (0.4%), mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (0.3%), shërbimet për transport (0.3%), pemët (0.2%), sheqeri, reçeli, mjalti, çokollata dhe ëmbëlsirat (0.2%), pijet joalkoolike (0.2%), duhani (0.2%), lendet djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (0.2%), blerjet e automjeteve (0.2%), shërbimet hoteliere (0.2%), prodhimet ushqimore (0.1%), veshjet (0.1 %), mirëmbajtja dhe rregullimi i vendbanimit (0.1%), mobileje dhe orendi, qilima dhe mbulesa të tjera dysHEMEJE (0.1%), qelqurinat, takëmet dhe mjetet e kuzhinës (0.1%), veglat dhe pajisjet për shtëpi dhe kopsht (0.1%), gjërat dhe pajisjet tjera rekreative, kopshtet dhe manaret (0.1%) dhe kujdesi personal (0.1%)

me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 6.7 %.

Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: karburantet dhe lubrifikantet për pajisjet e transportit personal (- 1.2 %) me një ndikim prej -1,2 për qind në IHÇK-it.⁷

⁷ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin maj 2023

Numri i ndërmarrjeve të regjistruara gjatë TM1 - 2023

Në TM1 2023, gjithsej janë regjistruar 3.086 ndërmarrje, ku krahasuar me tremujorin paraprak (TM4 2022) ka një ngritje për 17.07% të ndërmarrjeve të regjistruara. Ndërsa krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak (TM1 2022) ka një rritje për 9.0% të ndërmarrjeve të regjistruara.

Fig.6 Numri i ndërmarrjeve të regjistruara dhe atyre të shuara sipas viteve



Aktivitetet ekonomike më të preferuara gjatë këtij tremujori ishin: Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i mjeteve motorike, motoçikletave me 762 ndërmarrje të regjistruara (24.7%); Prodhimi me 353 ndërmarrje të regjistruara (11.4%);

Ndërtimtaria me 325 ndërmarrje të regjistruara (10.5%); Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike me 309 ndërmarrje të regjistruara (10.0%); Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimeve me ushqim me 271 ndërmarrje të regjistruara (8.8%) etj.

Fig.7 Numri i ndërmarrjeve të regjistruara dhe atyre të shuara sipas tremujoreve



Ndërkaq, sipas kategorisë së të punësuarve në ndërmarrjet e regjistruara në këtë tremujor, ishin: në kategorinë me 1 deri në 4 të punësuar janë gjithsej 2 988 ndërmarrje të regjistruara (96.8%); në kategorinë me 5 deri 9 të punësuar janë 69 sosh (2.2%); në kategorinë me 10 deri në 19 të punësuar janë 19 ndërmarrje

të regjistruara (0.6%); me 20 deri 249 të punësuar janë 9 ndërmarrje të regjistruara (0.3%); ndërsa në kategorinë me 250 e më shumë të punësuar është vetëm 1 ndërmarrje e regjistruar. Sa i përket shtrirjes gjeografike të ndërmarrjeve të regjistruara në nivel të komunave prin komuna e Prishtinës me 862 ndërmarrje të regjistruara (27.9%); Ferizaj me 267 ndërmarrje të regjistruara (8.6%); Prizreni me 261 ndërmarrje të regjistruara (8.4%); Gjilani me 172 ndërmarrje të regjistruara (5.6%); Peja me 160 ndërmarrje të regjistruara (5.2%); dhe Fushë Kosova me 124 ndërmarrje të regjistruara (4.0%). Ndërsa, komunat e tjera kanë numër më të vogël të ndërmarrjeve të regjistruara në këtë tremujor.⁸

⁸ ASK- Numri I ndërmarrjeve të regjistruara gjatë TM1 - 2023

Norma efektive të interesit në bankat komerciale (për muajin Maj 2023)⁹	
Norma në kredi[^]	6.5%
<i>për ekonomitë familjare</i>	6.1%
prej të cilave konsumuese	6.3%
prej të cilave hipotekare	5.3%
<i>për ndërmarrje</i>	6.8%
prej të cilave bujqësore	7.4%
prej të cilave industriale	6.9%
prej të cilave shërbyese	6.6%
Norma në depozita^{^^}	1.8%
<i>të ekonomive familjare</i>	1.7%
prej të cilave të transferueshme	0.0%
prej të cilave të kursimeve	0.2%
prej të cilave të afatizuara	1.7%
<i>të ndërmarrjeve</i>	2.6%
prej të cilave të transferueshme	0.0%
prej të cilave të kursimeve	0.2%
prej të cilave të afatizuara	2.6%
Dallimi i normës Kredi – Depozita	4.8 pp
[^] mesatare e peshuar e normave të interesit për kreditë e reja	
^{^^} mesatare e peshuar e normave të interesit në depozitat e reja	

⁹ Banka Qendrore e Kosovës – Informatat mujore të sistemit financiar, maj 2023

Njësitë rajonale të Odës Ekonomike të Kosovës nëpër Kosovë***Njësia Rajonale Pejë:***

Personi kontaktues: z. Samir Lleshi
Rr. Çarshia e gjatë -
Qendra tregtare Burma kati.2, 30000 Pejë
Tel: 045/ 560 - 999
email: samir.lleshi@oek-kcc.org

Njësia Rajonale Mitrovicë:

Personi kontaktues: z. Besart Kostanica
Rr. Mbretëresha Teutë, p.n. 40010 Mitrovicë
Tel: 045/ 619 - 519
email: Besart.kostanica@oek-kcc.org

Njësia Rajonale Gjilan:

Personi kontaktues: z. Ibrahim Tahiri
Rr. Abdullah Tahiri, p.n. 60000 Gjilan
Tel: 045/ 699 692
email: ibrahim.tahiri@oek-kcc.org

Njësia Rajonale Ferizaj:

Personi kontaktues: z. Lulzim Azemi
Rr. Dëshmorët e Kombit, nr. 144, 70000 Ferizaj
Tel: 045/ 580 - 666
email: lulzim.azemi@oek-kcc.org

Njësia Rajonale Prizren:

Personi kontaktues: z. Armend Hyseni
Rr. Remzi Ademi, nr. 27, 20000 Prizren
Tel: 049/ 709 - 657
email: armend-hyseni@hotmail.com

Referencat

Agjencia e regjistrimit të bizneseve të Kosovës (ARBK) – Statistikat e tregtisë së jashtme maj 2023

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) – Repertori statistikor mbi ndermarrjet ekonomike në Kosovë
TM1 2023

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) – Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit maj 2023

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) – Bruto produkti vendor me qasjen e shpenzimeve dhe prodhimit
TM1 2023

Banka Qendrore e Kosovës – Sistemi financiar maj 2023

Departamenti për Analiza dhe Komunikim Strategjik

Buletini Ekonomik Mujor ofron një përditësim të disa prej zhvillimeve kyçe brenda disa sektorëve të ekonomisë për tremujorin raportues. Buletini është dizajnuar me qëllim që të jetë informativ për të gjithë lexuesit. Buletini mund të përdoret për punime kërkimore ose për qëllime prezantimi, vetëm me citimin e burimit.